



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 12.08.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës datës 07.08.2026, të parashtruar nga Operatori Ekonomik VIZION PLUS SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi-rregullimi i rrugëve fushore“, Nr. i prokurimit- 632-26-4955-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-033-521, nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit ekonomik VIZION PLUS SH.P.K dt.07.08.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi-rregullimi i rrugëve fushore “, Nr. i prokurimit- 632-26-4955-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-033-521, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, të datës 28.07.2026 të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Vërtetohet** DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, të publikuar me datë: 28.07.2026;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos *që* të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori ekonomik VIZION PLUS SH.P.K., me dt. 07.08.2026 ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi-rregullimi i rrugëve fushore “, Nr. i prokurimit- 632-26-4955-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-033-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 12.08.2026, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet e juaja janë të pa bazuara, sepse të gjitha këto mjete në listën për pajisje për këtë aktivitet të prokurimit, janë të nevojshme duke pas parasysh natyrën e punës dhe terrenin ku do të kryhet punimet sipas përshkrimit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

